



**REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI**  
**REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT**  
**REPUBLIKA KOSOVA – PRESEDNIK**

Në bazë të Nenit 84, pika 28, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe në bazë të Nenit 5 të Ligjit nr. 04/L-070, për Dhënien e Dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Presidentja e Republikës së Kosovës aprovon këtë:

**RREGULLORE**  
**MBI LLOJET E DEKORATAVE QË I JEP PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE**  
**PROCEDURAT PËR DHËNIEN E TYRE**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohen llojet e dekoratave, kriteret dhe procedurat e dhënies së tyre nga Presidenti i Republikës.

**Neni 2**

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore janë në pajtim me Ligjin për Dhënien e Dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

**Neni 3**

1. Dekoratat jepen nga Presidenti i Republikës së Kosovës në bazë të Nenit 84, pika 28, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin për Dhënien e Dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe me këtë Rregullore.
2. Dekorata sipas ligjit janë urdhri, medalja, çmimi, mirënjohjet dhe titujt e nderit.
  - Urdhri është Dekorata më e lartë që e jep Presidenti i Republikës së Kosovës. Është i praruar në ari.
  - Medalja është Dekorata që është e larë në argjend.
  - Çmimi Titulli i Nderit është Dekorata që është e larë në bronz.

#### **Neni 4**

Presidenti i Republikës së Kosovës jep këto dekorata:

1. Urdhri Hero i Kosovës
2. Urdhri i Lirisë
3. Urdhri i Pavarësisë
4. Urdhri Luftëtar i Lirisë "Adem Jashari"
5. Urdhri për Paqe, Demokraci dhe Humanizëm "Dr. Ibrahim Rugova"
6. Medalja Humanitare "Nëna Terezë"
7. Medalja e Paqes dhe Pajtitimit "Anton Çetta"
8. Medalja Presidenciale e Meritave (Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini, Sport, Siguri, dhe Shërbim Civil)
9. Medalja Ushtarake për Shërbim në Kosovë
10. Çmimi për Inovacione, Kërkime dhe Zhvillim
11. Titulli Ambasador Nderi i Kosovës

#### **DISPOZITAT E VEÇANTA**

##### **Neni 5**

**Urdhri "Hero i Kosovës"** u jepet personave që kanë bërë vepra sakrifice dhe trimërie për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Përmban portretin e Skënderbeut.

##### **Neni 6**

**Urdhri i Lirisë** u jepet personave për kontributin e tyre të lartë për Liri të Kosovës.

##### **Neni 7**

**Urdhri i Pavarësisë** u jepet personave për kontributin e tyre për pavarësinë e Kosovës.

##### **Neni 8**

**Urdhri Luftëtar i Lirisë “Adem Jashari”** u jepet personave për trimëri në luftën për liri. Përmban portretin e Adem Jasharit.

#### **Neni 9**

**Urdhri për Paqe, Demokraci dhe Humanizëm “Dr Ibrahim Rugova”** u jepet personave, vepra jetësore e të cilëve cilësohet si kontribut i veçantë për ndërtimin e paqes, zhvillimin e demokracisë dhe kultivimin e humanizmit. Përmban portretin e Ibrahim Rugovës.

#### **Neni 10**

**Medalja humanitare “Nëna Terezë”** u jepet personave që kontribuojnë në çështjet humanitare. Përmban portretin e Nënës Terezë.

#### **Neni 11**

**Medalja e “Paqes dhe e Pajtimit Anton Çetta”** u jepet personave që kanë kontribuar dhe kontribuojnë për paqen dhe pajtimin midis njerëzve. Përmban portretin e Anton Çettës.

#### **Neni 12**

**Medalja Presidenciale e Meritave** u jepet personave që me punën e tyre kanë kontribuar në fusha të veçanta si: arsim, shkencë, kulturë, rini, sport, siguri, shërbim civil.

#### **Neni 13**

**Medalja Ushtarake për Shërbim në Kosovë** u jepet ushtarakëve të Republikës së Kosovës e të huaj që kontribuojnë në aftësimin ushtarak e të mbrojtjes së vendit.

#### **Neni 14**

**Çmimi për Inovacione, Kërkime dhe Zhvillim** u jepet personave që tregojnë rezultate të jashtëzakonshme në fusha të caktuara të dijes, zhvillimit ekonomik dhe të teknologjisë.

#### **Neni 15**

**Titulli Ambasador Nderi i Kosovës** u jepet personave që kanë kontribuar dhe kontribuojnë për interesat dhe afirmimin e Republikës së Kosovës.

#### **Neni 16**

Dhënia e dekoratave mund të shoqërohet me një shpërblim në të holla sipas kritereve që do të përcaktohen me akt të veçantë nënligjor të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës.



#### **Neni 17**

Dekoratat e dhëna më parë e ruajnë vlefshmërinë.

#### **Neni 18**

Presidenti i Kosovës mund të themelojë edhe dekorata, urdhra, medalje e tituj të tjerë në përputhje me Ligjin.

### **PROCEDURA E DHËNIES SË DEKORATAVE NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

#### **Neni 19**

Presidenti i Republikës së Kosovës ka të drejtë të japë dekorata me vetiniciativë. Procedurat për dhënien e dekoratave janë paraparë me Ligjin për Dhënien e Dekoratave Nr. 04/L-070.

#### **Neni 20**

Të propozuarit për dekorim duhet të kenë arritje, kontribut dhe vlera të veçanta në shërbim të shoqërisë dhe të vendit.

Dekorimi nuk hyn në lëmin (fushën) e të drejtave dhe, si i tillë, nuk mund të kërkohet në rrugë individuale ose institucionale.

#### **Neni 21**

Propozimi për dekorim bëhet duke marrë parasysh meritat e individit apo institucionit në përputhje me Ligjin dhe me këtë Rregullore. E njëjta dekoratë nuk mund t'i jepet dy herë të njëjtit person ose institucion, e as nuk mund të jepet dekoratë më e ulët nga një dekoratë më e lartë që i është dhënë më parë të njëjtit person ose institucion.

#### **Neni 22**

Propozime nuk mund të bëhen për ata persona që kanë qenë të dënuar për krim të rëndë apo janë nën hetime sipas ligjeve në fuqi.

#### **Neni 23**

Propozimi për dekorim është i plotë dhe shqyrtohet në kohën e duhur, kur i plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) dërgohet dy muaj para veprimtarisë, përvjetorit apo ngjarjeve historike që i përkasin individit apo institucionit,
- b) firmoset nga titullari i institucionit që ka të drejtën e propozimit,

- c) shoqërohet me arsyetimin përkatës, ku paraqiten arritjet dhe meritat e veçanta të të propozuarit dhe biografia e personit të propozuar.

#### **Neni 24**

Të gjitha propozimet i drejtohen Sekretarit të Presidencës (Kabinetit të Presidentit), i cili ia kalon për procedurë të mëtejshme Komisionit Vlerësues për Dekorata, si dhe zyrtarit për dekorata në kuadër të Zyrës së Presidentit.

#### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 25**

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje pushojnë së vepruari të gjitha rregulloret e nxjerra më herët për këtë qëllim.

#### **Neni 26**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

Prishtinë, 10 maj 2012

  
Atifete Jahjaga  
Presidentë e Republikës së Kosovës